

KRITERIUMET E KORPUSIT TË PAQES PËR AKOMODIM TË VULLNETARËVE NË FAMILJE NIKOQIRE

- ✓ Dhomë me shtrat, dollap për rroba, tavolinë pune, çelës për mbylljen e dhomës, e cila do të shfrytëzohet vetëm nga vullnetari;
- ✓ Nxehëse në dhomë;
- ✓ Dritare që mbyllen mirë; dhe derë që mund të mbyllet me çelës;
- ✓ Qasje deri tek toaleti dhe banjoja; dhe bojler në banjo;
- ✓ Qasje në kuzhinë dhe në elementet për gatim;
- ✓ Vullnetari nuk mund të jetojë me familjen e bashkëpunëtorit ose personit përgjegjës në organizatën ose shkollën e vullnetarit.

FAMILJE NIKOQIRE PËR VULLNETARË TË KORPUSIT TË PAQES

Bëhuni pjesë e familjes sonë!

PERSONAT PËR KONTAKT:

Teuta Saljii
070 383 780

Aynur Kaso
071 366 428

Dragan Markoski
070 406 005

**Korpusi i Paqes Maqedonia
e Veriut**

rr. 8 Udarna Brigada nr. 2,
Shkup 1000

Email:

mk-pcv@peacecorps.gov

Tel: +389 2 3090-012

lok. 17, 23, 38

Çdo familje në Maqedoninë e Veriut që ka dëshirë të pranojë vullnetar apo vullnetare që të jetojë me ta si anëtar/e i/e familjes së tyre, mund të paraqitet tek Korpusi i Paqes. Akomodimi i vullnetarëve nuk duhet të jetë luksoz, por duhet të jetë mesatar dhe sipas standarteve lokale.

KUSH JANË VULLNETARËT E KORPUSIT TË PAQES?

Ata janë qytetarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me prejardhje të ndryshme etnike, si dhe gjini, moshë dhe profesione të ndryshme. Vullnetarët vijnë në Maqedoninë e Veriut me qëllim që të shkëmbejnë njohuri, të ndajnë dhe promovojnë kulturën amerikane dhe të mësojnë për kulturën në vendin tonë.



ÇFARË PUNOJNË?

Vullnetarët amerikanë qëndrojnë në Maqedoninë e Veriut për dy vite. Jetojnë me familje nikoqire dhe punojnë në komuna, organizata të shoqërisë civile dhe shkolla fillore apo të mesme. Qëllimi i punës së tyre është që të ndikojë në përmisimin dhe zhivllimin e kapacitetëve të organizatave dhe avancimin e mësimdhënies në gjuhën angleze.

PSE VULLNETARËT JETOJNË ME FAMILJE NIKOQIRE?

- Të mësojnë rreth kulturës dhe traditave në vendin tonë dhe të integrohen më lehtë.
- T'i kuptojnë dhe mësojnë se cilat janë dallimet dhe mes mënyrës së jetesës së amerikanëve dhe njerëzve në vendin tonë.
- Që më lehtë të integrohen në vendin ku do të jetojnë.
- Të praktikojnë dhe përforcojnë të mësuarit e gjuhës shqipe.

ÇFARË PËRFITON FAMILJA NIKOQIRE?

Familjet fitojnë një mik të ri, shok, shoqe, mësues për fëmijët e tyre, mundësi për të këmbyer kulturat dhe përvojat, këmbim të ideve dhe mënyrës së të jetuarit, momente të paçmueshme, si dhe një shumë simbolike të hollash.

MËNYRA E PAGESËS:

- Si mbulesë për shpenzimet për nxemje, rrymë elektrike dhe shpenzime të tjera familjet marrin 13000 MKD në muaj.
- Nëse në shtëpi ka kat të posaçëm me kuzhinë dhe banjo, atëherë familjet marrin 10 000 MKD në muaj, si dhe 6000 MKD në muaj për rrymë elektrike gjatë muajve nëntor-prill dhe 2000 MKD në muaj gjatë muajve maj – tetor.
- Vullnetarët i mbulojnë shpenzimet për ushqim.